

Vërejtje: Ky dokument është i vlefshëm vetëm nëse është përgatitur dhe nënshkruar në gjuhën maqedonse. Përkthimi i autorizuar në gjuhën shqipe shërben vetëm për ta kuptuar më mirë atë.

Kushtet e përgjithshme të Komercijalna Banka AD Skopje për lëshimin dhe përdorimin e kartës së debitit Visa Business Debit

1. Përkufizimet

• **Kushtet e përgjithshme** – Rregullat dhe kushtet e përgjithshme për lëshimin dhe përdorimin e kartës së debitit Visa Business Debit të Komercijalna Banka AD Skopje

• **Banka** - Komercijalna Banka AD Skopje

• **Karta** - Visa Business Debit karta, të cilën e lëshon përdoruesi i kartës në bazë të kërkesës së Aplikantit person fizik.

• **Aplikant** – person juridik i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, i cili dorëzon kërkesë për lëshimin e kartës së debitit Visa Business Debit.

• **Përdoruesi i kartës** – person fizik, të cilit Banka i ka lëshuar kartë debiti Visa Business Debit, e cila është pronë e personit juridik, por me emër dhe mbiemër të përdoruesit të shtypur në kartë me Kërkesë të përfaqësuesit ligjor.

• **Llogari transaksioni** – llogari transaksioni në denarë e Aplikantit e hapur në Bankë, e cila ngarkohet/miratohet për shumën e transaksionit, shpenzimeve dhe kompensimeve, të cilat ndodhin me përdorimin e kartës në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj.

• **Saldo e disponueshme e llogarisë së transaksionit** – mjete të disponueshme, mjetet vetanake të zvogëluara për mjetet e rezervuara (për transaksionet e autorizuara dhe të paarkëtuara dhe urdhërpagesa tjera që janë në pritje për pagesë)

• **Limiti ditor** – shuma e mjeteve, numri i transaksioneve dhe shuma maksimale e transaksionit, të cilat Përdoruesi i kartës mund t'i përdorë në interval kohor ditor në tregti apo si para të gatshme.

• **Shpenzime** - të gjitha borxhet për shumën e transaksioneve, shpenzimeve, anëtarësimeve dhe kompensimeve, të cilat ndodhin gjatë përdorimit të kartës.

• **Bankomat** – pajisje elektronike, e cila mundëson pagesën e parave të gatshme, por edhe shërbime të tjera, pa praninë e të punësuarve nga Banka.

• **Pikë shitjeje** – tregtar, i cili ka të lidhur Marrëveshje për shitjen e mallrave dhe shërbimeve nëpërmjet kartave të programit Visa International

• **POS** – terminal – pajisje elektronike e instaluar në pikat e shitjes, ose sportelet bankare, e cila shërben për realizimin elektronik të transaksioneve.

• **PIN (Personal identification number)** – numër i fshehtë personal identifikimi i përdoruesit të kartës, i cili shërben për identifikim gjatë përdorimit të kartës në bankomat dhe POS terminal

• **Dita e punës** – secila ditë, gjatë së cilës Banka dhe institucionet financiare në R. e Maqedonisë punojnë dhe kryejnë operacione financiare.

(termat e lartpërmendur të përdorur në numrin njëjës mund të përdoren edhe në numrin shumës dhe në trajtën e shquar, pa e humbur kuptimin e përcaktuar)

2. Lëshimi i kartës

• Kërkesë për lëshimin e kartës Visa Business Debit bën përfaqësuesi ligjor i Aplikantit. Përfaqësuesi ligjor i Aplikantit, në emër dhe për llogarinë e Aplikantit të kartës Visa Business Debit e garanton saktësinë e të dhënave të shënuara në Kërkesë, Aplikanti i pranon rregullat e punës me kartën Visa Business Debit dhe e merr përgjegjësinë e kryerjes së obligimeve të ndodhura gjatë përdorimit të kartës.

• Aplikanti patjetër të ketë hapur ose të hap llogari transaksioni në Bankë.

• Për të gjitha transaksionet e ndodhura me kartën/at (në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj) ngarkohet llogaria e transaksionit.

• Aplikanti në Bankë dorëzon Kërkesë të plotësuar, nënshkruar dhe të verifikuar për lëshimin e kartës së debitit Visa Business Debit.

• Aplikanti pajtohet që Banka t'i vërtetojë të gjitha të dhënat e shënuara në Kërkesë, si dhe të sigurojë informacione plotësuese për të.

• Banka vendosë për lëshimin e kartës pa obligim, që parashtuesit të kërkesës t'i jep sqarime për vendimin e saj.

• Nëse parashtuesi i kërkesës hap dorë nga lëshimi i kartës në përdorim pas miratimit të kërkesës për përgatitjen e kartës, obligohet t'i kompensojë të gjitha shpenzimet, të cilat dalin gjatë procedurës së lëshimit të kartës.

• Përdoruesi i kartës është i detyruar, që menjëherë pas pranimit të kartës, të njëjtën ta nënshkruaj me stilolet kimik, ku nënshkrimi duhet të jetë identik me nënshkrimin në Kërkesë dhe pasaportë. Përdoruesi i kartës e bartë tërë rrezikun dhe pasojat në rast të mos nënshkrimit të kartës.

• Kartat dhe numrat personal identifikues i tërheq personalisht Përdoruesi i kartës, ose personi i autorizuar me autorizim me shkrim nga ana e Aplikantit të kartës Visa Business Debit.

• Afati i vlefshmërisë është shënuar në kartë. Përdoruesi mund ta përdorë kartën vetëm në periudhën e shënuar në kartë.

• Të gjitha shpenzimet që dalin nga përdorimi i kartës ngarkohet llogaria e transaksionit në denarë e Aplikantit të kartës. Aplikanti i kartës Visa Business Debit mund ta ndërpresë të drejtën e përdorimit të kartës dhe për këtë është i detyruar me shkrim ta njoftojë Bankën dhe ta kthejë kartën të prerë. Në rast se Aplikanti nuk mund të vijë deri te zotërimi i kartës, procedura për pushimin e të drejtës së përdorimit të kartës zbatohet në bazë të njoftimit me shkrim, ku karta bllokohet dhe pamundësohet përdorimi i saj i mëtejshëm.

3. Ripërtëritja e kartës

- Nëse përdoruesi i kartës u përmbahet Kushteve të përgjithshme dhe nuk e anulon ripërtëritjen e kartës më së paku 30 ditë para kalimit të afatit të vlefshmërisë ajo automatikisht do të ripërtërihet dhe nuk është e nevojshme dorëzimi i kërkesës për ripërtëritjen e të njëjtës.
- Përdoruesi i kartës është i detyruar të kujdeset për datën e vlefshmërisë. Nëse nuk merr njoftim për ripërtëritjen e kartës deri në fund të muajit, i caktuar si afat i fundit, është i detyruar t'i drejtohet Bankës.
- Përdoruesi është i detyruar ta shkatërrojë (copëtojë) kartën e vjetër.
- Llogaria e transaksionit e personit juridik ngarkohet për shumën e anëtarësisë vjetore.

4. Përdorimi i kartës

- Karta nuk u b artet personave të dytë dhe mund ta përdorë vetëm përdoruesi i kartës, emri i të cilit është i shtypur në kartë.
- Përdoruesi i kartës mund ta përdorë kartën për pagesë pa para të gatshme të prodhimeve dhe shërbimeve në të gjitha pikat e shitjes në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë, ku është i vendosur simboli Visa.
- Karta mund të përdoret për tërheqjen e parave të gatshme në valutë vendore në të gjitha bankomatet e të gjitha bankave në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë, ku kanë të shënuar simbolin Visa Electron.
- Përdorimi i kartës jashtë vendit është në ingjerenat e Ligjit për punë me valuta dhe rregullave të tjera, të cilat e rregullojnë punën me valuta.
- Gjatë përdorimit të kartës në bankomat, përdoruesi identifikohet me PIN, kurse në POS terminalët me PIN dhe/ose nënshkrim, i cili duhet të jetë identik me nënshkrimin në kartë.
- Për evidencën e tij, Përdoruesi i kartës mban për vete një kopje të vërtetimit të shitblerjes.
- Të gjitha parregullsitë e hasura në vërtetimin e transaksionit të realizuar, përdoruesi i konteston menjëherë gjatë blerjes, përkatësisht përdorimit të shërbimit.
- Përdoruesi është i detyruar t'i ruajë të gjitha dokumentet në lidhje me pagesat e kryera me kartë më së paku 6 muaj. Me kërkesën e parë të Bankës, nëse për këtë lind nevoja, është i detyruar të njëjtat t'i dorëzojë në bankë.
- Përdoruesi i kartës duhet që, me kërkesë të shitësit të mallrave ose ofruesit të shërbimit, të legjitimohet me letërnjoftim ose pasaportë.
- PIN-i është i njohur vetëm për përdoruesin e kartës dhe i njëjti, duhet të trajtohet rreptësisht në mënyrë konfidenciale dhe nuk mund t'u jepet palëve të treta.
- PIN-i nuk duhet të shkruhet në kartë dhe nuk duhet të lejohet asnjë gjurmë e shkruar e tij.
- Në rast të humbjes apo harresës së PIN-it, përdoruesi i kartës duhet menjëherë të drejtohet në Bankë për lëshimin e PIN-it të ri.
- Përdorimi i kartës bëhet në kuadër të saldos së disponueshme, përkatësisht në kuadër të limitit ditor. Përdoruesi nuk duhet ta tejkalojë saldon e disponueshme dhe limitet ditore gjatë përdorimit të kartës.

5. Kompensime dhe provizione

- Të gjitha kompensimet dhe provizionet e lidhura me kartën paguhen në përputhje me Vendimin për tarifën e kompensimeve të Bankës. Për shumën e kompensimeve dhe provizioneve të përlogaritura ngarkohet llogaria e transaksionit, që shfaqen edhe në raportin e llogarisë.

6. Njoftime

- Për ndryshimet në llogari, si dhe për të gjitha ndryshimet që lidhen me punën me kartë, banka e njofton Aplikantin nëpërmjet Raportit.
- Aplikanti është i detyruar që së paku njëherë në muaj të merr raport në sportelet e Bankës, përkatësisht sipas mënyrës dhe intervalit kohor në përputhje me Marrëveshjen për llogarinë e transaksionit.

7. Reklamacionet

- Banka nuk merr përgjegjësi për cilësinë dhe sasinë e prodhimeve, përkatësisht shërbimet e blera me kartë.
- Reklamacionet lidhur me cilësinë dhe sasinë e prodhimeve, përkatësisht shërbimet e blera me kartë zgjidhen në pikën e shitjes.
- Nëse Përdoruesi i kartës konsideron se disa nga shpenzimet janë llogaritur dhe arkëtuar gabimisht, ose nuk i takojnë, mund të drejtohet tek Banka, duke i dorëzuar të gjitha llogaritë dhe dokumentet tjera relevante, të cilat Banka mund t'i kërkojë.
- Reklamacionet dërgohen nëpërmjet formularit të Bankës, në sportelet e saj të shënuara për pranimin e reklamacioneve për karta.
- Afati i dorëzimit të reklamacioneve është 20 (njëzet) ditë pas përfundimit të muajit kur është arkëtuar transaksioni. Në të kundërt, Banka do të konsiderojë se përdoruesi i kartës bazë pajtohet me shpenzimet e përgjithshme të shënuara në raport.
- Nëse Banka vërteton se reklamacioni është i arsyeshëm do të aprovojë llogarinë e Aplikantit, kurse në raste të reklamacioneve të paarsyeshme, Aplikanti i mban të gjitha shpenzimet që dalin nga procedura e reklamacionit.
- Afatin e zgjidhjes së reklamacionit e cakton Banka në përputhje me rregullat e Visa International.

8. Karta e humbur dhe e vjedhur

- Aplikanti i mban të gjitha pasojat dhe përgjegjësinë ligjore për përdorimin e paautorizuar të kartës.
- Përdoruesi është i detyruar t'u përmbahet masave të sigurisë gjatë përdorimit të kartës (p.sh. ta nënshkruajë kartën, të ruajë PIN-in në fshehtësi ndaras nga karta dhe të ngjashme).
- Përdoruesi i kartës është i detyruar menjëherë ta paraqesë humbjen, përkatësisht vjedhjen e kartës në Bankë në telefonin 02 3242-474, kurse njoftimin e njëjtë ta vërtetojë me dorëzimin urgjent të njoftimit me shkrim deri te Qendra e Bankës – Shërbimi për karta bankare ose në njësitë tjera organizative të Bankës-Degët dhe filialet.

- Në rast të humbjes apo vjedhjes së kartës, Përdoruesi i kartës mban përgjegjësi financiare për shpenzimet e bëra me kartë, përkatësisht 300 minuta pas njoftimit fillestar për humbjen ose vjedhjen e kartës.
- Nëse Përdoruesi i kartës nuk e respekton detyrimin e fshehtësisë, ose nuk u përmbahet masave të sigurisë gjatë përdorimit të kartës, është përgjegjës për çdo keqpërdorim të saj.
- Pas pranimit të njoftimit me shkrim për humbje apo vjedhje të kartës, përdoruesit, Banka i lëshon kartë të re. Shpenzimet për kartën e re dhe/ose PIN-in pas humbjes apo vjedhjes bien në kurriz të Aplikantit në përputhje me Vendimin për tarifat e kompensimeve të Bankës.
- Nëse përdoruesi e gjen kartën pas njoftimit të humbjes ose vjedhjes nuk duhet ta përdorë, por është i detyruar të njëjtën ta copëtojë dhe ta dorëzojë në Bankë. Shpenzimet e bëra me përdorimin e kartës të pavlefshme të gjetur arkëtohen në kurriz të llogarisë së Aplikantit.

9. Ndërprerja e të drejtës së përdorimit të kartës

- Karta është pronë e Bankës dhe me kërkesë të saj, Përdoruesi është i detyruar menjëherë ta kthejë të coptuar. Karta, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë apo është anuluar nuk guxon të përdoret. Banka mund të shkurojë përdorimin e kartës për periudhë të caktuar kohore ose përgjithmonë, ose të vendosë ta anulojë kartën në rastet në vijim:
 - kur përdoruesi i kartës tri herë njëra pas tjetrës shënon PIN-in gabimisht
 - kur është njoftuar vjedhje apo humbje e kartës dhe Përdoruesi e shfrytëzon kartën në kundërshtim me Kushtet e përgjithshme
 - kur llogaria e transaksionit nuk ka mbulesë për pagesën e shpenzimeve të arritura, përkatësisht e njëjta është jo aktive
 - në të gjitha rastet tjera sipas vlerësimit të Bankës, pa obligim të theksojë shkakun.
- Pika e shitjes mund të mbajë kartën dhe ta dorëzojë në Bankë, në rast se kartën e përdorë ndonjë person emri i të cilit nuk është i shënuar në kartë, nëse Banka ka lëshuar urdhëresë për marrjen e kartës, ose kartës i ka kaluar afati i vlefshmërisë.
- Aplikanti mund, në çdo moment, ta anulojë përdorimin e kartave më dorëzimin e deklaratës me shkrim deri te Banka – Shërbimi për karta bankare dhe me kthimin e kartave.

10. Dispozitat tjera

- Kushtet e përgjithshme janë pjesë përbërëse e Kërkesës për lëshimin e kartës
 - Me nënshkrimin e Kërkesës, Përdoruesi i kartës i pranon Kushtet e përgjithshme dhe deklaron se i ka të qarta.
 - Dispozitat nga Kushtet e përgjithshme i dedikohen Aplikantit si dhe secilit përdorues të kartës.
 - Banka e mban të drejtën e ndryshimit të Kushteve të përgjithshme, si dhe Tarifën e kompensimeve të shërbimeve të Komercijalna Banka AD Skopje, në përputhje me politikën afariste të Bankës dhe për të njëjtat e informon përdoruesin nëpërmjet ueb faqes së Bankës ose Raportit të llogarisë së transaksionit.
- Banka nuk mban asnjë lloj përgjegjësie nëse Përdoruesi i kartës nuk mund të përdorë kartën në situatat vijuese, që nuk janë nën kontrollin e Bankës:

- grevë ose rrethana të jashtëzakonshme;
- kur karta ka mbetur peng në pikën e shitjes apo në bankomat dhe e njëjta është e dëmtuar;
- kur për çfarëdo lloj shkakut pika e shitjes, banka ose bankomati nuk e pranon kartën.

- Banka obligohet t'i mbrojë të dhënat personale të Përdoruesit të kartës, në përputhje me rregullat ligjore.
- Çdo përdorim i kartës në kundërshtim të rregullave ligjore si dhe pagesën e mallrave dhe/ose shërbimeve që janë të ndaluara dhe dënohen me ligj.
- Çdo përdorim i kartës në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura, nënkupton konfiskim automatik të kartës, marrjen e masave në përputhje me rregullat ligjore, kurse dëmi i përgjithshëm material së bashku me interesin e bartë Aplikantit i kartës Visa Business Debit.
- Me nënshkrimin e Kërkesës, Përdoruesi i kartës vërteton se është i njohur me Kushtet e përgjithshme dhe se në përgjithësi pajtohet me ato dhe veprimet juridike, të cilat dalin nga të njëjtat.